



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Organizma ndërkombëtare (evropiane)

Ngarkesa: 3 kredite; 30 orë mësimore; 15 leksione / 15 seminare
Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I, Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Në këtë modul synohet që studenti të njihet me organizmat ndërkombëtare, procesin e funksionimit të sistemit ndërkombëtar dhe të komunikimit të aktorëve ndërkombëtarë, çështje këto të aktualitetit të cilat prekin profesionin e tij si përkthyes dhe interpret. Në një qasje ndërdisiplinore, gjuhësore (terminologjia) dhe jashtëgjuhësore (njohuri të fushës së shoqërisë ndërkombëtare), do të shihet ky sistem si brenda organizatave, ashtu edhe në marrëdhëniet që ato kanë me strukturat jashtë tyre duke marrë njëherazi njohuri rreth funksionimit të organizmave ndërkombëtare si edhe strategjive të komunikimit ndërinstitutional.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Thellim i njohurive të studentëve në lidhje me organizmat ndërkombëtare në aksin sinkronik dhe diakronik.
- Njohje me njohuri specifike të dinamikës së shoqërisë ndërkombëtare, funksionit, rolit dhe veprimtarisë së institucioneve ndërkombëtare në planin ndërkombëtar, shtetëror si edhe atë individual.
- Ndërthurje e njohurive jashtëgjuhësore të fushës së organizmave ndërkombëtare (evropiane) me atë të profesionit të tyre përkthyesit dhe interpretit dhe edukimit si qytetarë.
- Njohje e drejtpërdrejtë me terminologjinë e fushës dhe me aktorët kryesorë të marrëdhënieve ndërshtetërore - organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare joqeveritare, kriminalitetin transkufitar etj.

Objektivat specifike lëndore:

- Zhvillim i aftësisë për të përpunuar materiale që lidhen me aspektet tematike dhe gjuhësore të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Zhvillim i aftësisë për të qenë aktor i mirëfilltë i shoqërisë ndërkombëtare.
- Zhvillim i aftësisë për të zgjedhur tema kërkimore shkencore që mund të ngjallin debate dhe të jenë në interes publik.

Rezultate të pritshme:

Në fund të kursit synohet që studentët të kenë përfutur njohuri bazë e të thelluara, tematike e gjuhësore, mbi sistemin ndërkombëtar, aktorët, organizatat ndërkombëtare qeveritare dhe ato jo-qeveritare si edhe procesin e komunikimit, si brenda organizatave, ashtu edhe në marrëdhëniet që ato kanë me strukturat jashtë tyre.